



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

г./v. \_\_\_\_\_



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur, (KSHPK në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 55-të, të mbajtur më datë 17.11.2021 morri

### VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-4183/1 të datës 15.10.2021, për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor, e paraqitur nga një parashtrues i panjohur, REFUZOHET.

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent, për arsye se KSHPK-ja tashmë ka vepruar për të njëjtat pohime në lëndë dhe ka marrë vendim, brenda kompetencës së tij.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

### Arsyetim

Nga parashtrues i panjohur më 15.10.2021, është dorëzuar denoncim me pohime për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor të Zgjedhjeve Lokale 2021 dhe është formuar lënda me numër 12-4183/1 të datës 15.10.2021. Në denoncim janë nxjerrë pohime për keqpërdorim të mjeteve buxhetore gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2021 në lidhje me përdorimin e veturave zyrtare të /// për nevojat e fushatës së /// për shpërndarje të materialeve zgjedhore.

KSHPK-ja gjatë shqyrtimit të pretendimeve të lëndës konstaton se raporti i lëndës është me të njëjtat pretendime të lëndës me raportin që KSHPK-ja tashmë ka vepruar dhe i cili është i regjistruar me numrin 12-4015/1 nga 15.10.2021 dhe në të cilën në seancën e 54-të e KSHPK-së e mbajtur më 01.11.2021, është marrë vendim në kompetencë të saj. Me vendimin e miratuar me numër 12-4015/2 të datës 05.11.2021, KSHPK-ja ka vendosur që ta refuzojë denoncimin në fjalë për shkak se pretendimet në denoncim tregojnë keqpërdorim të mjeteve buxhetore gjatë fushatës zgjedhore – /// por për shkak për faktin se nuk ka të dhëna të qarta, fotografi, vendndodhje, kohë të ngjarjeve, KSHPK nuk ka mekanizma për veprim kompetent, dhe për shkak të seriozitetit të pretendimeve raporti i është dorëzuar veprimi kompetent në MPB të RMV-së. - ///.

Në bazë të të gjeturave, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim kompetent dhe vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
KRYETAR,  
Biljana Ivanovska

Punoi: J.C.

Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија

Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: [contact@dksk.org.mk](mailto:contact@dksk.org.mk)

тел/tel: +389 2 3248 930

<https://www.dksk.mk>

